

VENDIM
Nr.788, datë 26.11.2004

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS DHE TË PESHËS SË SHËRBIMEVE TË REZERVUARA
PËR OPERATORIN PUBLIK POSTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 14 e 11 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa e shërbimeve të rezervuara, të kryera nga operatori publik postar, për pranimin, përpunimin, transportin dhe dorëzimin e objekteve të korrespondencës së brendshme, të jetë më e vogël se trefishi i tarifave publike për një objekt të korrespondencës për peshën më të vogël të kategorisë së standardeve më të shpejta, nëse ka kategori të tilla, me kusht që pesha e tyre, të jetë më e vogël se 100 gram.

2. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano